# ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

*(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-23-5692-2-1-1**

*(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)*

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore**

*(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)*

# ANKESË

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

**N.T.SH. "UNISOFT"**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

*Rr. "Raif Pollomi", L1/2, Nr. 6*

*(Adresa)*

*Prishtinë, Kosovë* — *(Vendi)*

*10000* — *(Kodi postar)*

*+383 44 250 052* — *(Numri Telefonit)*

*(Numri i Faks-it)*

*Arianit Bytyqi*

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

*info@unisoft-rks.com*

*(Adresa elektronike)*

*08.09.2023*

*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

N.T.SH. UniSoft PRISHTINË

*(Nënshkrimi dhe vula)*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me* *PROKURË.*
*Shëno të dhënat si në vijim:*

______________________________________________
*(Emri i avokatit)*

______________________________________________
*(Adresa e plotë)*

______________________ ______________________
*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

______________________
*(Adresa elektronike)*

______________________ ______________________
*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

| **Lloji i dokumentit** | **Data e publikuar** |
|---|---|
| B05 Njoftim per Kontrat | 07.06.2023 |
| Informacionet shtesë | 30.06.2023 |
| Procesverbali hapjes | 20.07.2023 |
| Vendimi i AK | 18.08.2023 |
| Kërkesë për qasje ne dosje te tenderit | 21.08.2023 |
| Kerkesa per Rishqyrtim | 23.08.2023 |
| Vendimi i Kerkeses per Rishqyrtim | 30.08.2023 |

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☐

Kërkesa për Rishqyrtim dorëzohet tek AK- MPB, sipas RROUP dhe LPP

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [X] **Jo** [ ]

**6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka proceduar në kundërshtim me:**

- **Neni 1 – paragrafi 1**
- **Neni 7 – paragrafi 1,2,3,4,6**
- **Neni 59 – paragrafi 1,2,4**
- **Neni 62 – paragrafi 1,2**

**Neni 72 – paragrafi 1,2,3**

**7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

**Neni 1 – paragrafi 1 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**

**Neni 1 - Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

**Deklarata, Faktet dhe argumentet:**

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK- MPB nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 1.

Ne si OE NTSH UNISOFT kemi aplikuar në projektin në fjalë dhe jemi të përgjegjshëm, AK ka kryer shkelje duke mos i përmbushur dhe respektuar detyrimet si autoritet kontraktues sipas nenit 1 të LPP.

AK – MPB dhe Komisioni i Vlerësimit ka shpallur një OE i cili është i papërgjegjshëm dhe me çmimin më të lartë.

Oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët sipas Dosjes së tenderit, Njoftimit për kontratë: NTSH UNISOFT (Arianit R. Bytyqi B.I. ) Çmimi 235,976.40 €

Oferta e shpallur fitues nga AK – MPB me vendimin e datës 18.08.2023 në kundërshtim me dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë. : InterAdria L.L.C. 244,260.00 €.

AK – MPB dhe komisioni i vlerësimin kanë vendosur që fondet mos të shfrytëzohen në mënyrë efikase por të shpallet fitues një OE i papërgjegjshëm.

AK – MPB dhe komisioni i vlerësues kanë dëmtuar Buxhetin e MPB dhe RKS në vlerë prej 8,284.00 €.

*Shih dokumentacionet dhe provat shtesë të bashkangjitura*

**20230720 Proces verbali i hapjes se Tenderve 20.07.2023**

## Neni 7 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

### Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat

për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

**Deklarata, Faktet dhe argumentet:**

Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK- MPB nuk ka trajtuar ne parim RROUP dhe LLP sipas nenit 7.

Ne si OE N.T.SH. UNISOFT me vendimin e AK-së datës 18.08.2023 për ta shpallur fitues një OE të papërgjegjshëm (InterAdria L.L.C.) dhe duke na eliminuar ne si OE (NTSH UNISOFT) ne jemi të diskriminuar, pasi që jemi OE i cili jemi të përgjegjshëm me çmimin më të ulët dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat të cilat janë në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

AK – MPB – Komisioni i Vlerësimit nuk ka vlerësuar drejtë ofertat.

*Shih dokumentacionet dhe provat shtesë të bashkangjitura*

**Dokumente Prova - InterAdria stafi**

**Dokumentacione Prova Menaxheri Projektitk Fisnik Meha**

**Dokumentacione Prova Zhvilluesi Softuerit Arjanit Bajrami**

**Neni 59 – paragrafi 1,4 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**

**Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**

1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacion dytësor lidhur me këtë çështje.
2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

**Deklarata, Faktet dhe argumentet:**

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – MPB dhe Komisioni i Vlerësimit i përbërë nga znj. Selvete Gjonbalaj, z.Fatos Idrizi dhe z. Agron Hoti nuk ka

trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 1, 7, 59, 60, 72.

Dhe se ne si OE NTSH UNISOFT jemi ofertë e përgjegjshme dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj ne si OE pretendojmë që AK- MPB nuk ka kryer ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. AK- MPB dhe komisioni vlerësues janë përgjegjës individualisht për trajtimin e ofertës tonë jo në përputhje me këto dispozitë.

**Deklarata, Faktet dhe argumentet:**

*Kërkesa në Dosjen e Tenderit , Njoftimit për kontratë tek fleta e të dhenave të tenderit (FTD)*

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

| ***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** | *Dokumentet e dorëzuara nga OE NTSH UNISOFT*<br>*Z.* ***Fisnik Meha– Menaxher i projektit*** |
|---|---|
| **Diploma përkatëse , CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (origjinal) Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje).**<br><br>**Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave kompjuterike - min. 5 vite përvojë pune ne menaxhim projekteve dhe zhvillim te aplikacioneve.** | *OE NTSH UNISOFT, Arianit R. Bytyqi B.I. ka dorëzuar si dokumentacionet sipas kerkeses në dosjen e tenderti dhe njoftimit për kontratë.*<br><br>***DHE se z. Fisnik Meha , Menaxher i projektit i plotëson të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë.***<br><br>***Dhe është person i përgjegjshëm për pozitën e caktuar nga OE NTSH UNISOFT*** |
| *Fisnik Meha – Menaxher i Projektit*<br><br>*Lista e stafit e nënshkruar dhe e vulosur:* | |

# STAFI

| Titulli i projektit: | |
|---|---|
| Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | |
| Nr. i e-Prokurimit: | 214-23-5692-2-1-1 |

## STAFI QË DO ANGAZHOHET NË PROJEKT NGA N.T.SH. UNISOFT

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Pozita | Përvoja |
|---|---|---|---|
| 1 | Fisnik Meha | Menaxheri i projektit | 12 vite |

N.T.SH. "UNISOFT"

Y.V.

Prishtinë, 20.07.2023

Adresa : Rr. Raif Pollomi, L1/2 Nr.6 , Prishtinë, Republika e Kosovës
web: www.unisoft-rks.com ; e-mail: info@unisoft-rks.com ; Mob: +383 (0) 44 250 052

*CV e nenshkaur nga z. Fisnik Meha si menaxher i projektit dhe eksperienca e punës:*

europass Curriculum vitae

PERSONAL INFORMATION

FISNIK MEHA

Lloshkobare, Ferizaj, Kosovo

WORK EXPERIENCE

N.T.SH. UNISOFT 01/2015 - Present
Project Manager

*Kontrata: OE NTSH UNISOFT – Fisnik Meha , Menaxher i Projektit*

# KONTRATË PUNE

PËR

KOHË TË CAKTUAR

**Neni 1**

Me këtë kontratë biznesi: **Arianit R. Bytyqi B.I** dhe me emrin tregtar: **N.T.SH. "UNISOFT"** e regjistruar në Agjensionin për Regjistrim të Biznesave me numër unik identifikues **810201294**, me adresë në **Prishtinë** , **Rr. Raif Pollimi, L1/2, Nr. 8**, e përfaqësuar nga **z. Arianit Bytyqi** me pozitën **Drejtor** dhe **Pronar** , (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë kontratë pune me:

**z. Fisnik Meha**, vendi i lindjes: **Ferizaj** me numër personal **2030289857** të lëshuar nga MPB e Kosovës , me kualifikim **Msc. Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi**, (në tekstin e mëtejshëm: I punësuari).

**Neni 2**

I punësuari caktohet në vendin e punës (pozita) : **Project Manager (Projekt Menaxher), Software and Database Devloper (Zhvillues i softuerit dhe i bazave të të dhënave),**

I punësuari do të kryej këto detyra të punës: Menaxhimin e projekteve, Zhvillim te aplikacioneve dhe sistemeve softuerike, zhvillim dhe dizajnimi i ueb faqeve, instalime dhe konfigurime te aplikacioneve softuerike, dizajnim dhe zhvillim te bazes se te dhenave, konfigurim dhe instalime te bazes se te dhenave, testime te aplikacionev softuerike, integrime dhe migrime te sistemeve. Dhe detyra tjera profesionale të cilat i merr nga punëdhënësi.

*Certifikime dhe trajnime si Projekt Menaxher dhe vendimin e menaxherit të projektit:*

## VENDIM PËR MENAXHER TË PROJEKTIT

| Titulli i projektit: | |
|---|---|
| Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | |
| **Nr. i e-Prokurimit:** | 214-23-5692-2-1-1 |

Kompania N.T.SH. "UNISOFT" ka vendosur që menaxher i projektit të jetë:

z. **Fisnik Meha** . MSc. of Computer Sciences

Përvoja mbi dhjetë (10) vjeçare në menaxhimin dhe koordinimin e projekteve të teknologjisë së informacionit garanton që projekti do të implementohet sipas kerkesave të kërkuar nga institucioni. Projektet e realizuara nga kompania N.T.SH. UNISOFT dhe të menaxhuara në detale mund ti gjeni në CV.

Projektet e realizuara nga kompania NTSH UNISOFT janë kryesisht të zhvilluara në platformën Microsoft (.Net & SQL Server)

Kompania NTSH UNISOFT është e fokusuar në zhvillimin, mirëmbajtjen dhe avancimet e aplikacioneve për sisteme të menaxhimit të studentëve dhe sisteme të menaxhimeve universitare, portale dhe ueb faqe për institucionet edukativo arsimore.

N.T.SH. "UNISOFT"

V. V.

N.T.SH. UniSoft PRISHTINË

Prishtinë, 20.07.2023

*Kërkesa në Dosjen e Tenderit , Njoftimit për kontratë tek fleta e të dhenave të tenderit (FTD)*

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

| **Dëshmia e kërkuar dokumentare:** | *Dokumentet e dorëzuara nga OE NTSH UNISOFT*<br>*Z.* ***Arjanit Bajrami – Zhvillues i softuerit*** |
|---|---|
| **Diploma përkatëse,**<br>**CV e nënshkruar nga inxhinieri-origjinal),**<br>**kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje),**<br>**Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje).**<br><br><br>**Zhvillues i softuerit duhet të jen inxhinier i kompjuterikes ose Baçelor i shkencave kompjuterike min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit ne zhvillim te aplikacioneve** | *OE NTSH UNISOFT, Arianit R. Bytyqi B.I. ka dorëzuar si dokumentacionet sipas kerkeses në dosjen e tenderti dhe njoftimit për kontratë.*<br><br>1. *CV e nënshkruar sips kërkesës*<br>2. *Kontrata ose marrveshja e punës*<br>3. *Referencat për përvojën e punës*<br><br><br>***DHE se z. Arjanit Bajrami , Zhvillues i softuerit i plotëson të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë.***<br><br>***Dhe është person i përgjegjshëm për pozitën e caktuar nga OE NTSH UNISOFT*** |

*z.* ***Arjanit Bajrami – Zhvillues i softuerit***

*Lista e stafit e nënshkruar dhe e vulosur:*

*CV e nenshkaur nga z.* ***Arjanit Bajrami – Zhvillues i softuerit*** *dhe eksperienca e punës:*

## WORK EXPERIENCE

**11/10/2017 – 05/06/2018** Prizren, Kosovo

### **Web Developer Junior** Blic Solution

**Internship**

**Website** http://www.blicsolution.com

**15/06/2019 – 24/09/2020** Pristina, Kosovo

### **Full Stack Developer in .NET MVC5 and Core** Cacttus.sha

Developer of **Backend** & **Frontend**
Number of project:

- 2

**Website** https://cacttus.com

**01/10/2020 – 01/07/2021** Pristina, Kosovo

### **Mobile Developer Flutter(Ios/Android)** eDev sh.p.k

Developer on Mobile IOS / Android - **Backend** & **Frontend**
Number of project:

- 1

**Website** https://etech-rks.com

**01/09/2021 – CURRENT** Pristina, Kosovo

### **Web Developer .NET MVC & Core** Unisoft

Developer of **Backend** & **Frontend**

**Website** http://www.unisoft-rks.com/

# KONTRATË PUNE
PËR
KOHË TË CAKTUAR

**Neni 1**


# KONTRATË PUNE
PËR
KOHË TË CAKTUAR

**Neni 1**


Me këtë kontratë biznesi: **Arianit R. Bytyqi B.I** dhe me emrin tregtar: **N.T.SH. "UNISOFT"** e regjistruar në Agjensionin për Regjistrim të Biznesave me numër unik identifikues **810201294**, me adresë në **Prishtinë** , **Rr. Raif Pollimi, L1/2, Nr. 8**, e përfaqësuar nga **z. Arianit Bytyqi** me pozitën **Drejtor** dhe **Pronar** , (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë kontratë pune me:

**z. Arjanit Bajrami**, vendi i lindjes **Gjilan** me numër personal **1244834473** _të lëshuar nga MPB e Kosovës , me kualifikim **Bsc. i Shkencave Kompjuterike**, (në tekstin e mëtejshëm: I punësuari).

**Neni 2**

I punësuari caktohet në vendin e punës (pozita) : **Software and Database Devloper (Zhvillues i softuerit dhe i bazave të të dhënave)**

I punësuari do të kryej këto detyra të punës: Zhvillim te aplikacioneve dhe sistemeve softuerike, zhvillim dhe dizajnimi i ueb faqeve, instalime dhe konfigurime te aplikacioneve softuerike, dizajnim dhe zhvillim te bazes se te dhenave, konfigurim dhe instalime te bazes se te dhenave, testime te aplikacionev softuerike, integrime dhe migrime te sistemeve. Dhe detyra tjera profesionale të cilat i merr nga punëdhënësi.

*Certifikime dhe trajnime, referenca si Zhvillues softueri :*

UniSoft

# LETËR REFERENCË

# PËRVOJA DHE PROJEKTET

| Titulli i projektit: | |
|---|---|
| Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | |
| Nr. i e-Prokurimit: | 214-23-5692-2-1-1 |

Ky dokument dëshmon se grupi i operatoreve **N.T.SH. "UNISOFT"** për projektit e lartcekur. Lëshon këtë referenc dokument i cili ka marrë pjesë dhe ka kryer punët e parapara me sukses në këto projekte të dhënet e të cilëve gjenden edhe ne CV:

| | |
|---|---|
| **z. Arjanit Bajrami** | User-interface dizajner |

| | |
|---|---|
| **Përvoja e punës** | 4 vite |

**Pjesëmarrja në projekte (3 vite):**

1. Mirëmbajtja e Sistemit Elektornik të Menaxhimit të Punëve me Studentë në Universitetin e Prishtinës,
2. Ofrimi i CMS dhe Dizajnimi, Ristrukturimi i UEB faqeve të UP-së,
3. Shërbimet e programit elektronik për testime gjatë procesit të rekrutimit,
4. Krijimi i bazës qendrore së të dhënave për regjistrimin e personave të zhvendosur dhe të kthyerve
5. Mirëmbajtja e sistemit digjital të fakultetit për siguri publike

N.T.SH. "UNISOFT"
z. Arianit Bytyqi

V.V.

Prishtinë, 20.07.2023

Adresa : Rr. Raif Pollomi, L1/2 Nr.6 , Prishtinë, Republika e Kosovës
web: www.unisoft-rks.com ; e-mail: info@unisoft-rks.com ; Mob: +383 (0) 44 250 052

**Bashkangjitur gjeni :**
**Shtoja 1 - NTSH UNISOFT**
**Shtojca 1 MenaxherProjektit FisnikMeha – dosja**
**Shtojca 1 ZhilluesSoftueri ArjanitBajrami - dosja**

*(FTD)*
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

| ***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** | *Dokumentet e dorëzuara nga OE InterAdria LLC*<br>*Znj.* ***MIRANDA KAJTAZI – Menaxher i projektit*** |
|---|---|
| **Diploma përkatëse , CV e nënshkruar nga inxhinieri-(origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi –(origjinal) Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje).**<br><br>**Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave kompjuterike - min. 5 vite përvojë pune ne menaxhim projekteve dhe zhvillim te aplikacioneve.** | *OE InterAdria LLC ka dorëzuar si reference, parakontratë dhe diploma në pozitë Menaxherit të Projektitk znj. Miranda Kajtazi.*<br><br>***Diploma e znj. Miranda Kajtazi nuk i plotëson kriterin e përshtatshmërisë lidhur me diplomën sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontartë si dhe pas sqarimeve nga AK – MPB.***<br><br>*Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave kompjuterike - min. 5 vite përvojë pune ne menaxhim projekteve dhe zhvillim te aplikacioneve.*<br><br>*Znj. Miranda Kajtazi (OE InterAdria LLC) ka dorëzuar diplomat:*<br>*Bachelor – Shkenca Kompjuterike koha e përfundimit 17.07.2006 180 ECTS kredi në Universiteti i Evropes Juglindore – Tetovë*<br>***Shih Diplomën bashkangjitur.***<br><br>*Master i shkencave , koha e përfundimit 24 Gusht 2007*<br>***Diploma e masterit nuk specifikon kreditë ECTS dhe është e pa mundur të merren 120 ECTS kredi për të fitur titullin Master i shkencave kompjuterike Brenda periudhe më pas se 12 muaj. !!!***<br>***Shih Diplomën bashkangjitur.***<br><br>***DIPLOMAT E znj. Miranda Kajtazi duhet verifikuar me saktësi dokumentacionet dhe noterizimi I diplomave bachelor dhe master është si një dokumente.***<br>***Lidhur me ECTS kredi dhe diplomen e masterit duhet ti drejtoheni për sqarim institucioneve adekuate për verifikimin në vendin e përfundimit të shkollimit dhe institucioneve kompetente në republikën e kosovës.*** |
| *Znj. Miranda Kajtazi në CV nuk i përmbush kriterin që Menaxheri i projektit të ketë 5 vite përvojë pune në menaxhimin e projekteve dhe zhvillimin e aplikacioneve.*<br>*Znj. Miranda Kajtazi ka menxhuar vetëm dy projekte sipas CV* | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| April 2013 – December 2016 | Ministry of Public Administration | Interadria / Mrs. Shpresa Kajtazi +377 (0) 44 120 753 | Project Manager and Quality Assurance |
| May 2014 – December 2015 | Office of the General Auditor | Interadria / Mrs. Shpresa Kajtazi | Deputy Project Manager |

**Project:** Development, supply, implementation support and maintenance of the Upgrade/Modification of Human Resources Management Information System (ECSIS), linkage of ECSIS with Payroll System and Payroll System with Treasury for Ministry of Public Administration needs and World Bank Requirements

**Role:** Project Manager and Quality Assurance Expert

**Project:** Development, supply, implementation support and maintenance of the Human Resources Management Information System (ECSIS), for the specific needs of the OAG

*Në të gjitha projektet e listuara në CV ka pa role tjera Consultant, Quality Assurance Expert, Developer, Researcher.*

***Por Projekt Menaxher sipas CV nuk i plotëson kushtet sipas NJK, DT që Menaxheri i projektit të ketë 5 vite përvojë pune në menaxhimin e projekteve.***

Dok pdf Miranda Kajtazi CV
Dok pdf Miranda Kajtazi diploma

*Kërkesa në Dosjen e Tenderit , Njoftimit për kontratë tek fleta e të dhenave të tenderit (FTD)*

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

| ***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** | *Dokumentet e dorëzuara nga OE InterAdria LLC*<br>*Znj.* ***IRIS EFENDIU – Ndihmës Menaxher i projektit*** |
|---|---|
| **Diploma përkatëse , CV e nënshkruar nga inxhinieri-(origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (origjinal) Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje).**<br><br>**Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave kompjuterike - min. 5 vite përvojë pune ne menaxhim projekteve dhe zhvillim te aplikacioneve.** | *OE InterAdria LLC ka dorëzuar si reference, parakontratë dhe diploma në pozitë Zhvillues i softuerit z. Migjen Belegu.*<br><br>***Diploma e znj. Iris Efendiu nuk i plotëson kriterin e përshtatshmërisë lidhur me diplomën sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontartë si dhe pas sqarimeve nga AK – MPB.***<br><br>*Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave kompjuterike - min. 5 vite përvojë pune ne menaxhim projekteve dhe zhvillim te aplikacioneve.*<br><br>*Zn. Iris Efendiu (OE InterAdria LLC) ka dorëzuar diplomat:*<br>***Bachelor – Shkenca Kompjuterike*** *koha e përfundimit 23.11.2017 në Kolegji AAB*<br>***Shih Diplomën bashkangjitur.***<br><br>***Master i Arteve në Menaxhment****, koha e përfundimit 26.12.2022 në Kolegji Universum*<br>***Shih Diplomën bashkangjitur.***<br><br>***DIPLOMAT E znj. Iris Efendiu Master I Arteve në Menaxhment, nuk i plotëson*** |



DIPLOMË
E STUDIMEVE PASDIPLOMIKE - MASTER
IRIS (NEVZAT) EFENDIU
LINDUR MË 21.01.1993 NË PRISHTINË, KOMUNA PRISHTINË
ËSHTË REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK 2020/2021
MË DATË 20.12.2022 MBROJTI TEZËN E STUDIMEVE MASTER
"RËNDËSIA E APLIKIMIT TË TEKNOLOGJISË
NË MENAXHIMIN E PROJEKTEVE"
NË PROGRAMIN MENAXHMENT
SPECIALIZIMI MENAXHMENT
DHE FITOI GRADËN:
MASTER I ARTEVE NË MENAXHMENT
ME SPECIALIZIM NË MENAXHMENT
Niveli i 7 i kualifikimit sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve KKK/KEK
Gjithsej 120 ECTS kredi të fituara
Nota mesatare gjatë studimeve 9.40
Nr. 2488/22, datë 26.12.2022

*Kërkesa në Dosjen e Tenderit , Njoftimit për kontratë tek fleta e të dhenave të tenderit (FTD)*

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

| ***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** | *Dokumentet e dorëzuara nga OE InterAdria LLC*<br>*Znj.* ***ARIANA KAJTAZI – Zhvillues i softuerit*** |
|---|---|
| **Diploma përkatëse,**<br>**CV e nënshkruar nga inxhinieri- origjinal),**<br>**kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje),**<br>**Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit–(kopje).**<br><br><br>**Zhvillues i softuerit duhet të jen inxhinier i kompjuterikes ose Baçelor i shkencave kompjuterike min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit ne zhvillim te aplikacioneve** | *OE InterAdria LLC ka dorëzuar si reference, parakontratë dhe diploma në pozitë Zhvillues i softuerit znj. Ariana Kajtazi.*<br><br>***Diploma e znj. Artiana Kajtazi nuk I plotëson kriterin e përshtatshmërisë lidhur me diplomën sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontartë si dhe pas sqarimeve nga AK – MPB.***<br>*Zhvilluesi i softuerit duhet të jetë inxhinier i kompjuterikës ose Bachelor i shkencave kompjuterike.*<br><br>*Z. Ariana Kajtazi (OE InterAdria LLC) ka dorëzuar diploma me titull:* ***Bachelor i Shkencave të Informatikës. Diploma e lëshuar nga Vaxjo Universitet I cili aktualisht nuk mund të gjedet as në ueb faqe. Nuk I përmbajn të dhënat e kualifikimit dhe ECTS kredit.***<br>***Shih Diplomën bashkangjitur.***<br><br>*Z. Ariana Kajtazi (OE InterAdria LLC) ka dorëzuar diploma me titull:* ***Degree of Master of Science (Master Shkencor) Teknologie masterexamen (Diplomë master në teknologji)***<br>***Shih Diplomën bashkangjitur.***<br><br>***DIPLOMAT E Znj. Ariana Kajtazi nuk i përmbushin kriteret sipas Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Kontratë*** |

**Ariana Kajtazi**
Namn/*Name*

född den 26 april 1986, har avlagt
*born on April 26, 1986, has been awarded the degree of*

**FILOSOFIE KANDIDATEXAMEN**

BACHELOR OF SCIENCE

Huvudområde: Informatik
*Major subject: Informatics*

Växjö universitet den 13 november 2008
*Växjö University, November 13, 2008*

Ariana Kajtazi

har avlagt

Teknologie masterexamen

*has been awarded the*

*Degree of Master of Science (120 credits)*

*Kërkesa në Dosjen e Tenderit , Njoftimit për kontratë tek fleta e të dhenave të tenderit (FTD)*

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

| ***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** | *Dokumentet e dorëzuara nga OE InterAdria LLC*<br>*Z. **MIGJEN BELEGU – Zhvillues i softuerit*** |
|---|---|
| **Diploma përkatëse,**<br>**CV e nënshkruar nga inxhinieri- origjinal),**<br>**kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje),**<br>**Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje).**<br>**Zhvillues i softuerit duhet të jen inxhinier i kompjuterikes ose Baçelor i shkencave kompjuterike min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit ne zhvillim te aplikacioneve** | *OE InterAdria LLC ka dorëzuar si reference, parakontratë dhe diploma në pozitë Zhvillues i softuerit z. Migjen Belegu.*<br><br>***Diploma e z. Migjen Belegut nuk I plotëson kriterin e përshtatshmërisë lidhur me diplomën sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontartë si dhe pas sqarimeve nga AK – MPB.***<br><br>*Zhvilluesi i softuerit duhet të jetë inxhinier i kompjuterikës ose Bachelor i shkencave kompjuterike.*<br><br>*Z. Migjen Belegu (OE InterAdria LLC) ka dorëzuar diploma me titull: **Bachelor I Shkencave të Inxhinierisë Elektrike – Departamenti Telekomunikacion.***<br><br>***Shih Diplomën bashkangjitur.***<br><br>***DIPLOMAT E z. Migjen Belegu nuk i përmbushin kriteret sipas Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Kontratë*** |

Diplomë Diploma

**MIGJEN BAHRI BELEGU**

U lind më 30.08.1990 në Pejë.
U regjistrua në vitin akademik 2009/2010.
Studimet i mbaroi më 25 qershor 2013 në:
DEPARTAMENTI TELEKOMUNIKACION

dhe mori titullin:
**BACHELOR I SHKENCAVE TË INXHINIERISË ELEKTRIKE**

Born on 30.08.1990 in Pejë.
Was enrolled in the academic year 2009/2010.
Completed his/her studies on 25 June 2013 in:
DEPARTMENT OF TELECOMMUNICATION

and was awarded the title:
**BACHELOR OF SCIENCE IN ELECTRICAL ENGINEERING**

**Shtojca 2 Dokumente Prova - InterAdria stafi**

**Neni 60 – paragrafi 1,2 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**

**Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës**

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

   1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

   1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 te këtij ligji.

**Deklarata, Faktet dhe argumentet:**

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK- MPB nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 60.

AK – MPB dhe Komisioni i Vlerësimit me vendimin e datës 18.08.2023 ka shpallur një OE i cili është i papërgjegjshëm dhe me çmimin më të lartë.

Oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët sipas Dosjes së tenderit, Njoftimit për kontratë: NTSH UNISOFT (Arianit R. Bytyqi B.I. ) Çmimi 235,976.40 €

Oferta e shpallur fitues nga AK – MPB me vendimin e datës 18.08.2023 në kundërshtim me dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë. : InterAdria L.L.C. 244,260.00 €.

**Neni 72 – paragrafi 1,2,3 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

**Deklarata, Faktet dhe argumentet:**

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK- MPB nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 72.

AK – MPB dhe Komisioni i vlerësimit ka mundur që duke shfrytëzuar nenin 72, dhe 59.2 AK – MPB dhe komisioni i vlerësimit të kërkoj sqarime lidhur me pjesët e tenderit të cilat dorëzohen nga OE.

Vendimi i datës 18.08.2023 është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenin 72, dhe 59.2 LPP dhe RROUP

Kërkojm nga P.SH. i OSHP që të nxjerr:

**VENDIM**

I. **APROVOHET,** si e bazuar Ankesa e NTSH UNISOFT (Arianit R. Bytyqi B.I.)
II. **ANULOHET** Vendimi i datës 18.08.2023 i AK- MPB dhe lënda të kthehet në Rivlerësim dhe ne si OE NTSH UNISOFT të shpërblehemi me kontratë

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Ne si OE : Arianit R. Bytyqi (N.T.SH. UNISOFT) kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhet me këtë procedurë të prokurimit. Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo material e i cili shtrihet edhe në raport me LMD neni 136, 137 duke mos u kufizuar edhe në dëmtimin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.**

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*